

rë, ashtu edhe i pari e ka për nder që të priten mirë prej të dytit kur nonjë herë t' i bjerë udhë nga vëndi i tij.

Hospitaliteti nuk është vetëm për njerëzit e një fisi, kur nosta nonjë herë do këtë rastin që t' ja çpërbletë, po edhe për të huajt. Venë kaq n'ekstrëmitet sa të presin nënë strehën e tyre edhe një njeri me të cilin munt të kenë rënë në gjak. Jo vetëm që i japin një të tilli haje, pije dhe vent për të fjetur, po edhe mprojtje. "Ka hangër bukën t'eme," thotë burr' i dhëut, dhe me këtë mënyrë nuk shkel ligjin e moçmë. Në qoftë se d kush damton mikun i cili ka patur ngrënë bukë në një shtëpi të nderçmë, damtuësi është përgjegjës kundrejt të zotit të shtëpisë sepse ka çnderuar mikun e tij, dhe naturisht edhe shtëpin' e tij.

Mirditasi, dhe përglithësisht Shqipëtarit, është fodull dhe i k'ënda që të bëjë dhe t' i bëjnë nder. Pa dëgion nonjë malësor të thotë: "Ke shtëpia e filanit më kan bâ nder të math." Jep rëndësi vëndit ku e venë, u ve veshin fjalëve që i thonë, shëkon llojin e giellës që i japin, dhe vere vëndin ku e venë të flerë, etj. Më të tjera fjalë, është sado sansiblë në gjërat që kanë të bëjnë me të bërit e nderit.

Në Mirditë fjala mik ka respektin më të math dhe, sado familja të jetë e vobektë, do